



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. i prot. 3019 Më 09.11 2018
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA

Emri i Autoritetit Kontraktues: **Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi, dhe**

Emri i Kontraktuesit: **"ZENA" Sh.p.k. me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Xhemajli Zena**
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS: PUNIMI I MURIT MBROJTËS TEK QENDRA RINORE NË RAHOVEC

Numri i Prokurimit: 623-18-7682-5-3-6

Numri i Brendshëm: 623-18-067-5-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Punimi i murit mbrojtës tek qendra rinore në Rahovec – Sipas Specifikacionit dhe Ofertës.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **09.11.2018** dhe përfundon me: **Sipas dinamikës së punëve, brenda**

Kontratës: 3 muaj, dhe përfundon me dorëzimin e Situacionit përfundimtarë.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *[shëno numrin]* ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **Në Rahovec.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **7,995.90 €**,

[Shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë Euro e nëntëdhjetë Cent] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: **10 % e vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [3 muaj + 30 ditë].**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore


13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Xhemajli Zena	Emri:	Jetulla Kabashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.11.2018	Data:	09.11.2018
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Punimi murit mbrojtës tek Qendra Rinore në Rahovec


I PUNET E DHEUT DHE TË ZHAVORIT					
Nr.	Përshkrimi i Posicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2	Gërmimi i dheut të kat. së III-IV-të, për hapjen e themeleve shiritore me prerje terthore 150*06 m, si dhe dim: 0.6*0.4 m' ngarkimi dhe transporti në deponi të qytetit në largësi deri në 5km.	m³	35	2	70.00
3	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-32)mm' nën bazën e themeleve shirit me trashësi t=10cm'.	m³	3.5	8	28.00
Totali :					98.00

II PUNET E BETONIT DHE ARMATURES					
Nr.	Përshkrimi i Posicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve dhe mureve nga betoni i markesa Mb-30Mpa, sipas detajev te dhena ne porjek si dhe betonimi rapes per automjete .	m3	62	56	3,472.00
2	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi, perpunimi si dhe vuarja ne veper e armaturës Ø(8, 10, 12) mm	kg	2450	0.58	1,421.00
3	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi, perpunimi si dhe vuarja ne veper e armaturës rrjet ne mure, rrjeta vendoset ne dy zonat e murit dhe ate (Q335), Ø8/150x150mm'.	copë	5	30	150.00
Totali :					5,043.00

III PUNET E NDRYSHME					
Nr.	Pozicioni	Nj. Matëse	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Furnizimi , transportimi dhe mbushja mbrapa murit me zhavor fr. 2-4 mm' per krijimin e mundesis se drenazimit te ujrave atmosferike dhe nentoksore deri ne nivelin e rruges ne varse te ternit.	m3	120	3.5	420.00
2	Furnizimi dhe mbushja me materja rrethanor dhe mbushje sterile per punimi e rapes per levizjen e automjeteve.	m3	30	4	120.00
3	Furnizimi dhe vendosja ne funt te muri gypin e drenazhes fi 125mm' me ramje per largimin e ujrave atmosferike dhe nentoksore ku gypi duhet te perforcohet me beton ne gjdo 3m'.	m'	46	2.4	110.40
4	Furnizimi dhe mbushja me zhavor 0-63mm' me mbushje h=30cm' si dhe ngjeshja e mbushje deri ne mberritjen e modulit te shafitjes Mv-60 Mpa , ne pjese ku duhet te punohet trotuari per gjate segmentit te rruges.	m3	30	5	150.00



5	Furnizimi dhe mbushja me zhavor 0-31mm' me mbushje h=10cm' si dhe ngjeshja e mbushje deri ne mberritjen e modulit te shafitjes Mv-60 Mpa , ne pjese ku duhet te punohet trotuari per gjate segmentit te rruges.	m3	10	6	60.00
6	Furnizimi dhe mbushja me zhavor 2-4mm' me mbushje h=4cm' per rrafshimin dhe krijimi per mundesin e kubzimit te trotuarit.	m3	4	8	32.00
7	Furnizimi, transportimi dhe montimi I kubzave te betoni me soliditet ne shtypje MB-40Mpa, me trashesi te kubzes t=8cm' forma ti pershtate pjese tjeter te trotuarit, ne qmim duhet te perfshihet edhe mbushja e fugave si dhe punimet tjera percjellse per kete pozicion.	m2	80	7.5	600.00
8	Furnizimi, transportimi dhe montimi I rrethojes mbi murin mbrojtës nga profilit metalik , mbajtsit kryesor 60*60mm' , ndarjet horizontale dy ndarje 40*20mm' si ndarjet vertikale ne gjdo 15cm' 20*20mm' , lartesia e rrethojes duhet te jetë h=1.2m', ne qmim duhet te parashifen te gjitha punimet tjera percjellse per kete pozicion si nakerimi , ngjyrosja kunder korozioni si dhe dy shtresa ngjyr metalike.	m'	36	25	900.00
9	Pastrimi i rrethojes egzistuese si dhe montimi I tyre te rapa per automjete ne te dy anet e rapes nga rrethoja e cila eshte ne punishte ne kuader te objektit , si dhe ankerimi dhe ngjyrosja kunder korozionit dhe dy shtresa ngjyr metalike.	m'	17	2.5	42.50
10	Furnizimi , transoprtimi dhe montimi I dyerve te rapa dy krishe nga profilat metalik sipas detajeve te dhen ne projekt , ku ne njer prej krahut te deres duhet te jete edhe nje derë 90cm' per mundesi kyqe per hapjen e dyerve, ndersa dyert duhet te punohen me dim: H=120cm' L=400 cm'	copë	1	390	390.00
11	Demolimi I dyerve me gjeresi 2m' dhe lartesi 1.5' te cilat jane te montuara per hyrje dhe dalje per kembesor, pastrimi I tyre nga korozioni, lyerja me ngjyr kunder korozionit, si dhe dy shtresa ngjyr metalik si dhe montimi I tyre ne murin e ri te punuar.	copë	1	30	30.00
Totali :					2,854.90




REKAPITULIMI		
I	PUNET E DHEUT DHE TË ZHAVORIT	98.00
II	PUNET E BETONIT DHE ARMATURES	5,043.00
III	PUNET E NDRYSHME	2,854.90
TOTALI ME TVSH:		7,995.90